

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE TË AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT,
INTEGRIMIT TË ZONAWE/NDËRTIMEVE INFORMALE, SHKODËR

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Shkodër, me objekt: *“Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë financiare, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 21.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 159, datë 23.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 576/8, datë 23.12.2013, i ka rekomanduar z. Besnik Kastrati, Drejtor i Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit, Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Shkodër, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër të marrë masa, për të bashkëngjitur parcelave ndërtimore sipërfaqet e poseduara, por të pa llogaritura për pagesë, në 50 rastet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, me sipërfaqe totale 20,038 m² dhe me vlerë të llogaritur **177,832,630 lekë**.

Në rastet kur këto sipërfaqe posedohen nga më shumë se nga një individë dhe është e pamundur të konfigurohen parcela të veçanta ndërtimore, të bashkëpunohet me njësitë e qeverisjes vendore dhe ZVRPP-në në terren dhe të veprohet sipas kërkesave të nenit 17 pika 1, të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 *“Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integritin e ndërtimeve pa leje”*.

2. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, në vijimësi, për dosjet e papërfunduara, për parcelat e zëna në prona shtetërore e publike, të zbatohet nenin 17 pika 1, të ligjit nr 9482 datë 03.04.2006, për sipërfaqet e truallit mbi 500 m², të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen, t'i bashkëlidhen parcelës ndërtimore dhe t'i shiten pronarit të truallit me çmimin e tregut.

3. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t , të përgatisë gen planet në bashkëpunim me organet e njësisive të qeverisjes vendore, në zbatim të germës a, të nenit 27 *“Dokumentet tekniko ligjorë për legalizimin e objekteve”* të ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006.

4. ALUIZNI Qarkut Shkodër, në përmbushje të funksioneve të veta, të hartojë skicat fushore në konfiguracion me përmasat reale e që përputhen me konfiguracionin e parcelës së pasqyruar në ortofoton digjitale dhe në hartën vektoriale, sipas Manualit të ALUIZNI-t, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008 *“Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (gen-plan, ortofoto, planimetri) të objektit që legalizohet”*.

5. Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Qarku Shkodër, të marrë masa që matjet për hartimin e procesverbaleve të konstatimit, të kryhen në vijueshmëri territoriale, bazuar në ndarjen e zonave kadastrale, duke përcaktuar rast pas rasti nevojën ose jo që për parcela ndërtimore

mbi 500 m² të konfigurohen parcela të veçanta për ndërtime, duke vendosur numra pasurie për pronë shtet për këto parcela dhe të inventarizohen dhe administrohen nga ALUIZNI Qarku Shkodër, si dhe të dërgohen në ZVRPP për regjistrim.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë administrative e ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit **1,200,048 lekë**, si më poshtë:

1. Z. Z.P.R., vlera **73,567 lekë**, pasi nuk është paguar vlera shtesë për 34 m² sipërfaqe, që përdoret për aktivitet social ekonomik.

2. Vlera **58,525 lekë** në 8 raste, për llogaritje çmimi gabim, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, në mospërputhje me VKM nr. 4, date 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2011-2012”.

3. Z. Z.B. vlera **210,000 lekë**, pasi në pagesën e bërë për sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej 350 m², në vlerën 825,000 lekë, nuk është respektuar kufiri dhe raporti ligjor, mes sasisë së bonove të privatizimit dhe pagesës me lekë në dorë. Është paguar vlera prej 490,000 lekë bono privatizimi, ndërsa duhej të paguhej shuma 280,000 lekë bono privatizimi. Është paguar vlera me lekë në dorë prej 335,000 lekë, ndërsa duhej të paguhej shuma prej 545,000 lekë. Është paguar më pak lekë në dorë 210,000 lekë dhe më shumë bono privatizimi 210,000 lekë, në mospërputhje me nenin 2 të ligjit nr.10219, datë 4.02.2010 për disa shtesa në nenin 20/c të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

4. Z. M.G. vlera **506,200 lekë**, pasi në pagesën e bërë për sipërfaqen ndërtimore prej 429,84 m², nuk është respektuar kufiri dhe raporti, bono privatizimi dhe pagesës me lekë në dorë. Është paguar vlera prej 1,250,000 lekë bono privatizimi, ndërsa duhej të paguhej shuma 743,800 lekë bono privatizimi. Është paguar vlera me lekë në dorë prej 1,097,600 lekë, ndërsa duhej të paguhej shuma prej 1,603,800 lekë. Është paguar më pak me lekë në dorë 506,200 lekë dhe më shumë bono privatizimi 506,200 lekë, në mospërputhje me nenin 25 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006.

5. Z. A.A. vlera **16,000 lekë** dhe z. A.R. vlera **25,000 lekë**, pasi kanë përfituara padrejtësisht dieta, në vitin 2011 dhe 2012.

6. Z. A.A. vlera **66,738 lekë** dhe z. A.R. vlera **25,000 lekë**, zj. A.G. 17,279 lekë, pasi për vitin 2011 dhe 2012, si rrjedhojë e tejkalim të normativave të konsumit të karburantit për automjetin e institucionit, rezulton një diferencë prej 1,946 litra benzinë.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37, 140, 141 dhe 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të nxjerrë për emërimin në detyrë, t’i kërkohet Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNIT, fillimin e masës disiplinore, “*Ndërprerje të marrëdhënieve të punës*” për:

1.z. A.A. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër,

2. **z. E.SH.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve,
3. **z. G.L.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve,
4. **zj. P.K.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit Fillestar,

Për shkak se gjatë përbushjes të detyrave përkatëse nga të katër drejtuesit, janë konstatuar veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenin 3 germa “f” dhe nenin 17 pika 1, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” të ndryshuar, si dhe me Manualin e ALUIZNI-t, me qëllim zvogëlimin e parcelës ndërtimore deri në limitin prej 500 m² në 50 raste me sipërfaqe totale 20,038 m² dhe vlerë të llogaritur 177,832,630 lekë, e cila paraqitet si mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit për kompensimin e ish- pronarëve dhe cënim i interesit publik.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 576/11, datë 31.12.2013 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër:

1. **A.A.** me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër,
2. **G.L.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve,
3. **E.SH.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimeve,
4. **P.K.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit Fillestar,
5. **N.J.** me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë,
6. **B.J.** me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë,
7. **F.P.** me detyrë ish Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë,

Pasi në kundërshtim me nenet 3, 17 dhe 20 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, kanë zvogëluar parcelat ndërtimore gjatë procedurës së legalizimit, krahasimisht me sipërfaqet e zëna sipas vetëdeklarimeve, ortofotove dhe skicave fushore që administrohen në dosjet e audituara, **për 50 raste**, duke pas sjellë një vlerë të munguar prej **177,832,630 lekë** dhe tjetërsim abuziv të sipërfaqeve tokësore shtetërore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Milo Pano, Besim Bileri, Sotir Kosdine dhe Xhemal Luka më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT